Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Megrant ing shpk" të datës 23.10.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi dhe mirëmbajtja e IEA" me nr. të prokurimit 616-26-7453-5-2-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

I. **MIRATOHET si pjesërisht e bazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Megrant ing shpk" të datës 23.10.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi dhe mirëmbajtja e IEA" me nr. të prokurimit 616-26-7453-5-2-1.

II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korigjimin e kërkesave në dosjen e tenderit.

III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën https://e-prokurimi.rks-gov.net.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Megrant ing shpk" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 23.10.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Renovimi dhe mirëmbajtja e IEA" me nr. të prokurimit 616-26-7453-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:
PRETENDIMI ANKIMOR NR. 1 – KUFIZIMI I PAARSYESHËM I PESHËS SË EKSKAVATORIT Dosja e Tenderit kërkon një (1) ekskavator me peshë 5–9 tonë. Kundërshtojmë vendosjen e kufirit maksimal prej 9 tonësh, pasi ky kufizim mund të përjashtojë operatorë ekonomikë që posedojnë ekskavatorë me peshë mbi 9 tonë, të cilët mund t'i kryejnë punët e kërkuara në mënyrë të njëjtë dhe të përshtatshme. Nëse qëllimi i kërkesës është sigurimi i një kapaciteti minimal për kryerjen e punimeve, përcaktimi i një kufiri maksimal duhet të mbështetet në nevojë konkrete, objektive dhe të arsyetuar teknikisht për këtë kontratë. Kërkojmë që kriteri të ndryshohet nga "një (1) ekskavator 5–9 tonë" në "një (1) ekskavator me peshë minimale 5 tonë", pa përcaktuar kufi maksimal, duke ruajtur mundësinë që operatorët ekonomikë me pajisje të përshtatshme dhe me kapacitet më të madh të marrin pjesë në procedurë.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 2 – KUFIZIMI I PESHËS SË EKSKAVATORIT NGARKUES (SKIP) Dosja e Tenderit kërkon një (1) ekskavator ngarkues (Skip) me peshë 6–8 tonë. Kundërshtojmë kufirin maksimal prej 8 tonësh, sepse ai nuk duhet të përdoret për të përjashtuar pajisje me peshë më të madhe, nëse ato janë të përshtatshme për realizimin e punëve të kontratës. Një kufizim i tillë duhet të jetë i domosdoshëm dhe i arsyetuar me kushtet konkrete të punimeve; në mungesë të një arsyetimi të tillë, mund të krijojë pengesë të panevojshme për konkurrencën. Kërkojmë që kriteri të ndryshohet në "një (1) ekskavator ngarkues (Skip) me peshë minimale 6 tonë", duke hequr kufirin maksimal prej 8 tonësh.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 3 – KUFIZIMI I PESHËS SË CILINDRIT (RULIT) NGJESHËS TË DHEUT Dosja e Tenderit kërkon një (1) cilindër (rul) ngjeshës të dheut me peshë prej 4 deri në 5 tonë. Kundërshtojmë kufirin maksimal prej 5 tonësh, pasi operatorët ekonomikë mund të posedojnë rula me peshë më të madhe që janë të përshtatshëm për punët e kërkuara. Përcaktimi i një intervali të ngushtë pa një arsyetim teknik specifik mund të kufizojë numrin e operatorëve që mund të konkurrojnë, pa dëshmuar se pajisjet më të rënda nuk mund t'i përmbushin nevojat e kontratës. Kërkojmë që kriteri të ndryshohet në "një (1) cilindër (rul) ngjeshës të dheut me peshë minimale 4 tonë", pa kufi maksimal të peshës.

PRETENDIMI ANKIMOR NR. 4 – PAQARTËSIA DHE MOSPËRPUTHJA NË DËSHMITË E KËRKUARA PËR STAFIN PROFESIONAL Në pjesën e kapacitetit profesional, Dosja e Tenderit kërkon që operatori ekonomik të dëshmojë se në resurset e veta njerëzore ka staf teknik prej së paku 10 punonjësish, përfshirë së paku një punonjës të certifikuar për instalimin e ujësjellësit dhe kanalizimit, të certifikuar edhe për testimin e gypave sipas EN 805, si dhe së paku një punëtor të certifikuar për saldimin e gypave HDPE sipas EN 13067:2013. Ndërkaq, te "Dëshmia 3" kërkohen lista e punëtorëve e nënshkruar dhe e vulosur nga OE, lista përkatëse e ATK-së dhe kontratat e rregullta të punës për punëtorët e angazhuar. Kjo mënyrë e formulimit krijon paqartësi se a kërkohet që të gjithë punëtorët dhe specialistët të jenë punonjës ekzistues të operatorit ekonomik në momentin e ofertimit, të deklaruar në ATK dhe me kontrata të rregullta pune, apo lejohet që operatori ekonomik t'i angazhojë ata për realizimin e kontratës në rast të shpërblimit me kontratë, përmes parakontratave ose marrëveshjeve të angazhimit. Nëse AK kërkon staf që do të kyçet në projekt, duhet ta bëjë të qartë se si mund të dëshmohet angazhimi i ardhshëm, pa e kufizuar pjesëmarrjen vetëm te operatorët që tashmë i kanë të gjithë punëtorët në listat e tyre të ATK-së. Kërkesa për listën e ATK-së dhe kontratat e rregullta të punës, e kombinuar me formulimin se stafi "do të kyçet në projekt", mund të interpretohet në mënyra të ndryshme dhe të krijojë trajtim jo të njëjtë të operatorëve ekonomikë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për specialistët me certifikime të veçanta, të cilët mund të sigurohen për realizimin e kontratës pas shpërblimit, për

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net

sa kohë që operatori ekonomik dëshmon në mënyrë të besueshme disponueshmërinë dhe angazhimin e tyre. Kërkojmë që Autoriteti Kontraktues ta sqarojë dhe ndryshojë këtë pjesë të Dosjes së Tenderit, duke përcaktuar shprehimisht se operatori ekonomik mund ta dëshmojë disponueshmërinë e stafit teknik edhe përmes parakontratave ose deklaratave/marrëveshjeve të angazhimit, përfshirë specialistët e certifikuar, krahas dëshmive të tjera të përshtatshme. Lista e ATK-së dhe kontratat e rregullta duhet të kërkohen në mënyrë të qartë dhe proporcionale për punonjësit që janë aktualisht të punësuar, por të mos interpretohen si kusht që përjashton automatikisht stafin që do të angazhohet për zbatimin e kontratës. AK duhet të specifikojë saktë se cilat dëshmi pranohen në fazën e ofertimit dhe cilat detyrime duhet të përmbushen para fillimit të punimeve.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, është gjetur se parashtruesi ka prezantuar argumente pjesërisht të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij ankimore. Rrjedhimisht AK në koordinim me njësinë kërkuese do të rishqyrtoj edhe njëherë kërkesat e DT me qëllim të harmonizimit të plotë me LPP dhe RRPP në fuqi.

Vlen të citohet neni 7 paragrafi 2 të LPP përmes të cilit përcaktohet se *"Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik"*.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pjesërisht pretendimet e tij ankimore. Prandaj kërkesa e tij për rishqyrtim është miratuar si e bazuar pjesërisht.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1.2. të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 28.10.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:
Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Adresa: Rr. "UÇK" nr. 2, Prishtinë 10000
Tel.: 038-200-40-111
Email: visar.shehu@rks-gov.net